



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE
AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

VENDIM

I

KËSHILLIT DREJTUES

NR. 2, DATË 03.10.2016

Sot, më datë 03.10.2016, në orën 12:00, në selinë e Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), u mbledh Këshilli Drejtues i ADISA, ku janë të pranishëm:

- Z. Lorenc Bako (Kryetar);
- Z. Artur Pilkati (Anëtar);
- Z. Bledar Doracaj (Anëtar);
- Z. Ervin Sherifaj (Anëtar);
- Znj. Juliana Hoxha (Anëtare).

Nuk janë të pranishëm në mbledhje dy anëtarë të Këshillit Drejtues:

- Znj. Alba Çaroshi;
- Z. Enea Hoti.

Në mbledhje mori pjesë gjithashtu Drejtori Ekzekutiv i ADISA, Znj. Anisa Gjika.

Këshilli Drejtues u mbledh dhe diskutoi për të vendosur lidhur me pikat e rendit të ditës, me të cilat ishin njohur nëpërmjet njoftimit më datë 27.09.2016.

Pasi diskutoi në lidhje me to, bazuar në Ligjin Nr. 13, datë 18.02.2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", Këshilli Drejtues, në unanimitet,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Rregulloren "Për organizimin e punës të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), bashkëngjitur këtij Vendimi;
2. Të miratojë Rregulloren e brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e administratës për Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)", bashkëngjitur këtij Vendimi;
3. Të miratojë Rregulloren e brendshme "Për funksionimin e sporteleve pritëse për qytetarët në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", bashkëngjitur këtij Vendimi;

Adresa: Bulevardi "Zhan d 'Ark", ish Hoteli i Oficerave, kati i 6-të Tiranë, Albania

E-mail: informacion@adisa.gov.al

4. Të miratojë kriteret e propozuara nga Drejtori Ekzekutiv, që do të zbatohen për punësimin e personelit të ADISA, bashkëngjitur këtij Vendimi;
5. Të miratojë Projekt Buxhetin e vitit 2017, bashkëngjitur këtij Vendimi.

Ky Vendim hartohet në 2 (dy) kopje.

Ngarkohet Drejtori Ekzekutiv i ADISA-s për ndjekjen e mëtejshme të procedurave në zbatim të tij.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

Lorenc Bala

